



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 947/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Meriton Xhemollari, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.947/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Meriton Xhemollari, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Meriton Xhemollari, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Prizren, me të cilin pretendon se në vendvotimin 2062A/01R posedon fakte nga deklaratat e vëzhguesve të certifikuar në këtë vendvotim se ka mospërputhje të votave nga evidencat e tyre dhe Formularëve të Përputhjes së Rezultateve-FPR. Më tej në apel parashtruesi shton se ka dyshime se votat e tij iu janë bartur tek një kandidat tjetër i po të njëjtit subjekt politik. Ndërsa në VV 2026A/04D, thekson se votuesi i ka argumentuar se i njëjti e ka votuar.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur kopje të FRP-ve dhe FRK-ve, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, provat që ka ofruar si dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për pasqyrim jo të drejtë të rezultateve edhe

pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përputhje të votave apo bartje të votave nga një kandidat tek kandidati tjetër të votave të parashtruesit të apelit, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Meriton Xhemollari, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga subjekti politik LVV, dega në Prizren, nuk është bazuar në dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit apo regjistrimit të votave për kandidat, andaj apeli i parashtruar vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Meriton Xhemollari, nuk është i bazuar me dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë regjistrimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.947/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.